



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.03.2010, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 12 mars 2019.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Ylli Shehu, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Pjerin Ndreu, Myslym Murrizi, Luan Harusha, Milva Ekonomi dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Elona Hoxha, Paulin Sterkaj dhe Antoneta Dhima

Të ftuar:

Sander Lleshaj- Ministër i Brendshëm

Julian Hodaj - Zëvendësministër i Brendshëm

Ardi Veliu - Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

Muhamet Rrumbullaku - Drejtor i SHÇBA-së

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Sigurisë Kombëtare. Sot në rendin e ditës kemi parashikuar miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 12 mars 2019, miratimin e kalendarit 3-javor të punës së komisionit, meqenëse në seancën e kaluar Kuvendi miratoi programin dhe kalendarin, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i njohur ndryshe si ligji për vetingun në Policinë e Shtetit.

Besoj se nga kolegët për 2 pikat e para të rendit të ditës, procesverbalin dhe kalendarin, nuk ka vërejtje dhe diskutime.

Ju prezantoj me të ftuarit që janë të pranishëm në komision për të na prezantuar ndryshimet në ligjin për vetingun e policisë, ministri i Brendshëm, zoti Sandër Lleshaj.

Zoti Ministër, faleminderit që jeni i pranishëm!

Zoti Julian Hoda, zëvendësministër i Brendshëm, zoti Ardi Veliu, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe zoti Muhamet Rrumbullaku, drejtor i Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave.

Ju falënderoj për prezencën tuaj!

Relator i komisionit për këtë projektligj është zoti Pjerin Ndreu. Ndërkohë të gjithë kolegët kanë përpara tabelën me ndryshimet që propozohen t’i bëhen ligjit për vetingun e policisë nga Ministria e Brendshme. Pa humbur kohë, duke respektuar edhe detyrimet që ka ministri, ia jap fjalën zoti Lleshaj që të na prezantojë ndryshimet e ligjit në fjalë.

Sandër Lleshaj – Mirëdita, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare,

Ardhja jonë në komisionin tuaj lidhet me një propozim të rëndësishëm që ka të bëjë me disa ndryshime në ligjin për vetingun, meqë po përdoret ky term, i cili lidhet me nevojat për ta bërë këtë ligj të zbatueshëm në mënyrë që ne të marrim atë produkt që synohet prej tij.

Policia e Shtetit është një ndër strukturat e administratës shtetërore dhe një institucion publik, i cili gëzon një besim të lartë publik, madje sipas shumë sondazheve të besueshme dhe me reputacion policia renditet në krye të institucioneve sa i takon besueshmërisë publike. Megjithatë,

kjo nuk do të thotë që edhe Policia e Shtetit të mos ketë nevojën për të parë nga radhët e saj, për të përmirësuar, për të kërkuar më shumë integritet, profesionalizëm dhe përkushtim nga punonjësit e saj, aq më tepër kur ne jemi në një fazë shumë të rëndësishme të reformës në drejtësi. Reforma në drejtësi është një fazë vendimtare, por ajo nuk mund ta lëvrojë ose ofrojë kurrë rezultatin e pritur pa pasur edhe një polici bashkëpunuese, për arsye se policia dhe organet e drejtësisë janë pjesë e të njëjtit sistem, i cili kujdeset për më shumë drejtësi në vendin tonë.

Pra, reforma në drejtësi dhe suksesi i saj është i lidhur shumë ngushtë me reformën në Policinë e Shtetit, ndër të tjera edhe me realizimin në cilësi dhe në kohën e duhur të vetingut.

Problemi kryesor që është identifikuar gjatë kësaj periudhe për ligjin për vetingun në Policinë e Shtetit lidhet me realizimin e tij. Sipas ligjit aktual vetingu në Policinë e Shtetit duhet të përfundojë në mars të vitit 2020. Në qoftë se ne do të konsiderojmë kohën që është dashur për të kaluar procesin e vetingut për rreth 100 prokurorë dhe gjyqtarë, gati rreth 2 vjet, do ta kuptojmë fare qartë se për të kaluar një proces të rregullt dhe të kujdesshëm vetingu për rreth 13000 punonjës të Policisë së Shtetit, të Gardës dhe të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe të Ankesave do të kërkonte një kohë shumë herë më të gjatë sesa koha që është praktikisht në dispozicion të ligjit aktual, për arsye se ligji ka parashikuar marsin e vitit 2020 vit në të cilin do të mbyllet procesi.

Duke parë këtë situatë pas diskutimeve të rëndësishme që janë kryer në strukturat e Ministrisë së Brendshme, të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat është konkluduar që ne duhet të ndërmarrim disa ndryshime formale, të cilat nuk prekin kurrësi thelbin e ligjit. Ndryshimet konsistojnë, pa hyrë në detaje, së pari, në heqjen e limitit kohor që ishte marsi i vitit 2020 për mbylljen e procesit. Pra, ne do t'i japim kohë vetes për ta vazhduar me procesin e vetingut edhe më gjatë në mënyrë që ai të realizohet gjerësisht.

Së dyti, nuk është prekur asnjë kriter dhe standard, por është ndryshuar diçka që ka të bëjë me trupat që do të kryejnë vetingun. Ligji aktual parashikon një trupë të jashtme vetingu dhe dy trupa të brendshme vetingu.

Çfarë është propozuar? Është propozuar që trupa e jashtme të mbetet, ndërkohë komisioni i jashtëm i vetingut, i cili përbëhet nga personalitete të caktuara nga fusha të ndryshme që kanë ardhur nga jashtë ministrisë, sistemit të policisë dhe organeve që vetohen, e ka filluar punën. Kjo trupë e jashtme do ta kryejë detyrën ashtu siç është në ligjin aktual, pra do të kryejë vetingun për pjesën kryesore të drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të SHÇBA-së. Ndërkohë, ligji aktual parashikon ngritjen e dy strukturave të tjera të brendshme të komisionit

qendror dhe të komisioneve vendore, të cilat do të kenë për detyrë më pas të vazhdojnë me procesin e vetingut për pjesën e mbetur të Policisë së Shtetit.

Sipas analizave tona krijimi i këtyre grupeve *ad hoc* është i komplikuar dhe nuk do të sillte atë që pritet as në kohën e duhur, as në cilësinë e duhur, për arsye se bëhet fjalë që trupat e brendshme të ngrihen me stafin e vetë Ministrisë së Brendshme në mënyrë që të largohen nga detyra dhe të kryejnë një funksion në kuadër të strukturave *ad hoc*.

Arsyetimi që bëhet është ky, derisa bëhet fjalë që ne do të kemi struktura të brendshme *ad hoc* të përbëra nga punonjës të vetë strukturave të Policisë së Shtetit, të SHÇBA-së apo të Gardës së Republikës, është konkluduar se këtë punë mund ta bëjë më mirë vetë SHÇBA-ja, e cila pas vetingut, kur të marrë trajtën e saj përfundimtare, pasi të certifikohet integriteti, profesionalizimi dhe kriteret të tjera për SHÇBA-në, të mund ta kryejë këtë funksion për pjesën e mbetur të Policisë së Shtetit, si dhe pa pasur një presion kohor në mënyrë që të ketë mundësi të punojë në qetësi dhe të respektojë të gjitha ato kriteret që janë parashikuar.

Ky propozim që bëhet për ta ngarkuar SHÇBA-në me vijimin e punës për pjesën tjetër të strukturave lidhet edhe me një fakt tjetër të rëndësishëm. Në fakt, SHÇBA-ja ekziston pikërisht për këtë, ajo është krijuar si institucion ose organ ligjor dhe është ngarkuar me detyrën të ruajë dhe të kujdeset që strukturat e Ministrisë së Brendshme, të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe SHÇBA-së të jenë struktura të vetuara, të jenë struktura me integritet, me profesionalizëm përkushtim dhe të ruhen nga çdo lloj infiltrimi i lidhjeve të papërshtatshme, i lidhjeve me krimin dhe fenomene të tjera, të cilat, për fat të keq, nuk janë të panjohura te ne.

Për ta përmbledhur do të thosha që në ligj nuk bëhet asnjë ndryshim substancial, i vetmi ndryshim është heqja e limitit kohor, mars 2020, që e bën ligjin praktikisht të pamundur për t'u zbatuar.

Gjithashtu, në vend të dy komisioneve të përkohshme, që do të ngriheshin me ligjin aktual, detyrën për të vetuar pjesën e mbetur të Policisë së Shtetit, Gardës dhe vetë SHÇBA-së të vazhdojë ta kryejë SHÇBA-ja.

Në fazën e parë, siç e thashë, nga komisioni i jashtëm i vetingut do të vetohet trupa drejtuese e Policisë së Shtetit, pra rreth 300 drejtues, që nga niveli komisariat e deri në Drejtorinë e Përgjithshme dhe SHÇBA-ja dhe pjesa tjetër do të kryhet nga vetë SHÇBA-ja, e cila e ka për mision ligjor të bëjë këtë detyrë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ministër për prezantimin!

Në vija të përgjithshme ky komision nëpërmjet nënkomisionit parlamentar, që ndjek monitorimin dhe zbatimin e ligjit për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit, ka ndjekur ecurinë e zbatimit të këtij projekti. Kujtoj që ligji ka hyrë në fuqi që në prill të vitit të kaluar, ndërkohë në shkurt është zgjidhur edhe problemi i pagesës së punonjësve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe na është bërë me dije nga ana e Ministrisë së Brendshme që janë siguruar edhe ambientet.

Ne e mirëpresim këtë ndërhyrje nga ana juaj, sepse tregon një reflektim për të parë konkretisht për zbatimin praktik të ligjit. Interesi i këtij komisioni dhe i të gjithëve është që ligji të mos humbasë thelbin e vet dhe, siç ju e prezantuat, nuk ndryshon gjë në thelbin e ligjit, ndërkohë që besoj se bëhemi më praktikë në mënyrën e organizimit të një procesi, i cili, në fakt, përfshin një numër shumë të madh punonjësish të Policisë së Shtetit.

Fjalën e ka zoti Ndreu për të bërë relatin.

Pjerin Ndreu - Faleminderit!

Ministri ishte shumë i qartë në shpjegimet që dha. Kjo është një çështje shumë sensitive, që ha debat edhe para edhe gjatë miratimit, madje kemi pasur edhe disa ide, por që në atë kohë nuk u morën parasysh.

Dëgjuam argumentet që dha ministri dhe kemi lexuar relacionin që keni sjellë, i cili ka të bëjë me kohëzgjatjen dhe pamundësinë për të kapur kohën e mbarimit, sipas ligjit, në vitin 2020. Gjithashtu, ka edhe një kosto të madhe financiare, e cila është e pamotivuar kur mekanizmat e kryerjes së vetingut janë **shërbimi i shërbimit të brendshëm**, i cili, në fakt, siç e tha ministri, e ka detyrë funksionale permanente të ndjekë çdo sektor të Policisë së Shtetit, por edhe të Ministrisë së Brendshme për të parë sa dhe si është integriteti i punonjësve të policisë në procesin e punës. Unë jam pro që të ketë një lehtësim të procedurave të kryerjes së këtij vetimi, duke pasur parasysh edhe një tension që ka shoqëruar organizatën gjatë kësaj kohe, i cili është reflektuar. Pra, ka një ankth dhe një tension në disa struktura të policisë.

Unë si relator kam disa sugjerime dhe mendoj se, përveç asaj që ne jemi dakord, duhet të shikojmë me vëmendje çdo strukturë. Garda është një shërbim që nuk ka impakt në publik, nuk është një shërbim i modelit të policisë, që ka marrëdhënie me popullatën dhe që mund të implikohet në afëra korruptive në sisteme të tilla, prandaj, duke qenë e tillë, unë mendoj se Garda duhet të përjashtohet nga kjo lloj skeme vetingu. Garda ka një rol shërbimi statike për personalitetet e larta të shtetit, homologët që vijnë dhe për rezidencat. Pra janë shërbime statike, por edhe nga përvoja që kemi neve nuk ka rezultuar se Garda ka qenë një institucion problematik sa i përket implikimit.

Ka pasur ndonjë rast tek –tuk, por nuk mund të jetë shkak që ta vetojmë. Policia ka tjetër pozicion, prandaj unë mendoj se duhet të ndahen.

Së dyti, unë kam besim absolut te drejtuesi i ri i SHÇBA-së, Muhamet Rrumbullaku, i cili është një nga vlerat e padiskutueshme të policisë në vite. Unë kam besim se ky shërbim do të marrë rrjedhën e duhur, sepse ka qenë një shërbim që është përdorur si presion i ministrit ndaj kujt do që nuk i pëlqente politikisht ose privatisht, ministrat e kanë keqpërdorur gjithmonë atë shërbim. Historia ka raste nga më skandalozet, këtë e kemi ngritur edhe në një dëgjese që e kemi bërë, por mendoj se burimi i informacioneve ose banka e informacioneve që përdor SHÇBA-ja është shumë e vjetruar. Ka informacione të 30-20-10 vjetëve, mbi bazën e të cilave shpeshherë janë gjykuar, janë paragjykuar ose penguar të ecin në karrierë oficerë të ndryshëm duke ia përplasë në sy këto informacione sipas interesave të dikujt për të bërë dëm. Unë mendoj se duhet të ketë një amnisti të këtyre informacioneve, zoti drejtor, sepse edhe, nëse flasim për ndonjë element, kontingjent që dyshojmë se kryen një krim nuk mund ta mbajmë informacionin më shumë se tre muaj, sepse oficeri i Policisë Kriminale pas tre muajsh është i detyruar t'i japë rrugë, ndërsa një oficer policie mbahet pambarimisht, përjashtoj rastet kur ka informacione që kanë sensibilitet të lartë, që lidhet me ngjarje të rënda dhe shumë të rënda. Ka një perceptim mbi bazën e këtyre informacioneve publike, që e njollosin policinë, dhe janë keqpërdorur në media dhe vazhdojnë të keqpërdoren dhe të shiten si prova. Situata ka derivuar në një moment të çuditshëm që merret një informacion apo indicio e pavërtetuar, kthehet në provë dhe shitet si argument. Shërbimi duhet të dalë nga ky batac. Shërbimi duhet ta bëjë vetëgjykimin mbi disa principe më të qarta duke shmangur subjektivitetin ose parëndësinë e këtyre informacioneve që kanë ngelur aty dhe i ka zënë pluhuri.

Ne kemi rënë dakord me drejtorin në dëgjесën që kemi bërë dhe unë kam besim se do ta shikoni me objektivitet.

Policinë e Shtetit të gjithë kanë dëshirë ta etiketojnë nga mëngjesi deri në darkë, kujt i teket, e njeh apo jo atë, e ka apo jo idenë se çfarë është Policia e Shtetit. Njerëzit, kur duan të të fyejnë, thonë “je polic”, kur duan të bëjnë policin, nuk të lënë radhë ta bësh. Pra, këtu është një çudi e madhe, por ne si Komision i Sigurisë kemi qenë dhe do të jemi gjithmonë në mbështetje të Policisë së Shtetit dhe të të gjithë punës së saj të pamohueshme dhe rezultateve të saj spektakolare që ka krijuar në vite. Është institucioni më i mirë i këtij vendi, më i besueshmi, më i vuajturi, më i sakrifikuari dhe meriton respekt.

Pikë së pari, vetingu duhet të jetë demonstrim respekti ndaj punonjësve të policisë dhe mbi këtë respekt ne do të jemi realisht të qartë dhe objektivë në gjykimet që do të vijnë më pas.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Është e qartë që më shumë se ky komision dhe më shumë sesa interesat e çdo ligji që lidhet me funksionimin e Policisë së Shtetit, është interesi i njerëzve, interesi i shqiptarëve, që ajo të jetë e fokusuar në luftën kundër krimit, sepse ky është misioni kryesor i saj. Unë besoj që të gjithë kemi dakordësi si anëtarë të këtij komisioni, por edhe si deputetë, të bëjmë ç'është e mundur që Policia e Shtetit të mos mënojë nga ky mision kaq i rëndësishëm i saj.

Sipas Rregullores, fjala është për kolegët e komisionit për pyetje, drejtuar përfaqësuesve dhe ministrit të Punëve të Brendshme, apo edhe relatorit.

Zoti Murrizi ka kërkuar fjalën.

Myslym Murrizi – Faleminderit!

Kolegu Ndreu preku qartë thelbin e problemit të ligjit të vetingut. Ajo që do të doja të shtoja është që duhet të jemi më të hapur me njëri-tjetrin, edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme.

Vetingut në polici erdhi si pasojë e delirit të atij që ju vutë ministër pas kampionit, pasi bëri vetingun në drejtësi, demek, dhe, po të kishte vazhduar gjatë e të ndërronte karrigen, të jeni të bindur që do të kishte veting në shëndetësi, në bujqësi apo në ushtri. U duk si shpikje e madhe dhe erdhi si pasojë e luftës së një ministri që do të pastronte pjesën e ministrit tjetër që gjeti.

Në ligjin e Policisë së Shtetit kemi organin e SHKB-së, sot SHÇBA-ja, e cila duhet të ishte lënë të punonte, sepse në 5 vjet e gjysmë nuk ka punuar, nuk është lënë, është përdorur si kamxhik nga cilido ministër, vetëm për të goditur pjesë që nuk i përkisnin klanit të tij.

Vetingu në Policinë e Shtetit nuk erdhi si rrufe në qiell të hapur. Raportet e Shërbimit Informativ, konfidencialisht drejtuar ministrave paraardhës, implikonin mbi 130 oficerë drejtues të mesëm dhe të lartë në numërimin e rrënjëve të hashashit, dhe në trafikun e drogës. Erdhi si pasojë pasi për 24 orë, në mes të Tiranës, u zhdukën 4 komisarë të mëdhenj policie, drejtori i Policisë së Vlorës, i Kufirit e me radhë që nuk i gjetët dot, që ishin të implikuar në grupin e Habilajve dhe, më pas, për të bërë show mediatik, thanë “o burra, të fusim 15 mijë punonjës policie e garde në veting dhe do ta bëjmë vetingun për 4-5 vjet”.

Po të kishte dëshirë dhe vullnet politik nga ata që kanë drejtuar Ministrinë e Brendshme, të jepnin frymëmarrje dhe personel të nevojshëm, mbështetje financiare dhe logjistike, absolutisht nuk do të kishin nevojë për një ligj propagandistik dhe demagogjik sikur po shpikim atomin a çfarë po bëjmë në sytë e botës.

Po mbas vitit 2020 që vetingu të mbarojë formalisht, kush do t'i kontrollojë njerëzit e korruptuar brenda radhëve të policisë? Cili komision apo organ është ky, sepse ata nuk bëhen imunë pas vitit 2020 dhe kjo s'do të thotë se do të jenë të gjithë engjëj dhe brenda radhëve të policisë nuk do të ketë më njerëz që shkelin ligjin, që implikohen me botën e krimit, apo njerëz që merren me trafiket brenda kësaj trupe. Dhe nuk janë pak, por janë 13 mijë policë, pa gardën. Pra, Xhafaj donte të pastronte pjesën e Tahirit. Fakti që brenda 5 vjetësh e gjysmë janë ndërruar 3 drejtorë të Përgjithshëm Policie, 4 shefa SHÇBA-je do të thotë se nuk kanë pasur vullnet politik ministrat për të frenuar implikimin e trupës policore me trafikantët dhe grupet e trafikut.

Doni të bëni realisht veting? Hiqni 530 oficerët e sigurimit që keni brenda, për të cilët keni nostalgji, hiqni ata 130 vetë që u ka dalë emri gjithandej në tabulate, i dini, filloni zbatimin e hierarkisë dhe karrierës duke filluar nga drejtori i Përgjithshëm, i cili ka marrë gradat pa qenë drejtues 10 vjet dhe pa qenë 15 vjet në organet e policisë. E keni bërë drejtues, sepse ashtu i ka konvnuar ministrit që ishte dhe lëreni të punojë. Shtoni personelin. Këtij numri punonjësish bëjini vetingun dhe lërinë të punojnë jashtë ndikimit të tutelës të çdo ministri që vjen. “Kur të vij unë ministër, dua ta kem me vete, se është kobure në duart e ministrit për të përjashtuar ata që nuk janë me mua”. Ky është vetingu.

Mos e fusni në siklet policin e fshatit dhe ta detyroni të japë dorëheqjen, sepse nuk ka dokumente që të justifikojë faturat e asaj shtëpie që ka ndërtuar djali i tij që ka punuar 30 vjet punë të zezë në Greqi dhe ka bërë një vilë, sepse djali i tij ka ikur siç kanë ikur 2 milionë shqiptarë si emigrantë. Nuk i ka ardhur e keqja këtij vendi nga policët e thjeshtë.

Po pastruat këta 500-600 veta gjithsej, që i keni nëpër këmbë dhe i keni marrë vet me bujë të madhe në tetor të vitit 2013, duke filluar nga Neritan Nallbati, mësues gjuhe, me korrespondencë, që e bëtë drejtor policie e me radhë, e keni kryer vetingun e policisë. Mos u bini më qafë 13 mijë policëve të thjeshtë!

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Murrizi, do të kisha dashur t'i përmbaheshim Rregullores, të bënim pyetjet dhe pastaj të kalonim te diskutimet.

Do të më duhet t'i lejoj një ndërhyrje zotit Lleshaj edhe për faktin që pak më herët më ka kërkuar mirëkuptimin e të gjithëve, që për shkak të një angazhimi jashtë vendit, ta lejojmë të ketë kohën e duhur për diskutim, e më pas të largohet.

Po ia kaloj fjalën zotit ministër dhe pastaj zotit Duzhaj.

Sandër Lleshaj – Faleminderit, zonja kryetare!

I mirëkuptoj komentet e zotit Murrizi dhe e falënderoj për ndërhyrjen!

Pak a shumë në ligj është kjo frymë. Ne synojmë të ngarkojmë organin, që ligji ka parashikuar ta bëjë këtë punë, për ta bërë vetingun, sepse vetingu nuk është një proces që bëhet sot dhe mbyllet nesër, por është një proces i përhershëm, pasi çdo prurje e re në Policinë e Shtetit apo në gardë duhet të verifikohet. Gjithashtu, edhe ata që janë të vetuar një herë nuk jua në të imunizuar, sepse nesër mund të bien në një ndikim të papërshtatshëm, mund të bëhen subjekte të një situatë të papërshtatshme, arsye për të cilat duhet të largohen.

Pra, vetingu është një proces që nuk mbaron kurrë, por është pjesë e natyrshme e çdo organizate, siç është Policia e Shtetit. Prandaj është edhe Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm.

Po e përmend paraprakisht, sepse thatë se ministrat janë kujdesur për klanin e tyre, ne në Shqipëri të gjithë kemi një klan: ka një klan Lleshi, një klan Murrizi, një klan ku di unë se çfarë. për fat të mirë, ky klani im nuk ka lidhje me Policinë e Shtetit. Po të kërkosh me lupën më të madhe, nuk e di a gjen një apo dy në Policinë e Shtetit, që kanë mbiemrin tim, qoftë edhe në ushtri, sepse nuk kemi qenë më parë shumë afër këtyre organeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka. Po të kishte do ta thosha, por nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'e kam këtë definicion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'e kam këtë definicion për klanin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Megjithatë, e mirëkuptoj atë shqetësimin, sipas të cilit SHQBA-ja duhet të jetë struktura që e bën përherë këtë punë dhe do të vazhdojë ta bëjë.

Ju përmendët rastet e oficerëve që kanë pasur lidhje me Sigurimin e Shtetit e të tjera me radhë. Sigurisht, në procesin e vetingut ky është një nga kriteret që ligji parashikon për t'u marrë

në konsideratë ata persona të cilët kanë lidhje të papërshtatshme dhe nuk garantojnë ato siguritë e nevojshme për të shërbyer në Policinë e Shtetit.

Lidhur me çështjet që ngriti zoti Ndreu, të cilat po ashtu kanë të bëjnë me SHQBA-në, në lidhje me informacionin e tejkaluar nga koha, të paverifikuar e të tjera me radhë, këto janë çështje që patjetër do të merren në konsideratë, qoftë nga Komisioni i Posaçëm i Vetingut, i cili tashmë ka filluar për pjesën drejtuese, qoftë nga SHQBA-ja për pjesën vijuese.

Sigurisht, që informacionet të shndërrohen në provë, ky është një proces i tërë. Ndodh nganjëherë që, në bazë të informacioneve të paverifikuara këtu ngrihen stuhi të mëdha e mbase edhe penalizohen njerëz, por unë besoj se komisionet përkatëse do ta kenë pjekurinë e nevojshme për të gjykuar dhe jo për t'u bërë automatë të informacionesh, që jo rrallë rezultojnë të paverifikuara, nganjëherë janë të dëmshme, nganjëherë të fabrikua, që në njëfarë mënyre janë implantuar në sistem.

Ne do të jemi të kujdesshëm në çdo rast, për të garantuar integritet të procesit, për aq sa na takon neve, megjithëse procesi bëhet jashtë nesh, së paku në pjesën kryesore të tij.

Lidhur me ato që thoni për Gardën e Republikës, ne nuk e kemi parashikuar, për arsye se nuk shohim ndonjë... Sigurisht, mund të hajë diskutim argumenti juaj, që garda është një shërbim, i cili nuk është tipikisht policim, por është një shërbim ruajtjeje nga afër të personaliteteve shtetërore. Megjithatë, si pjesë e Ministrisë së Brendshme, duke konsideruar edhe projektet për të ardhmen, ne nuk e kemi parashikuar përjashtimin e gardës nga ky proces. Për mendimin tim, por edhe mendimin e të gjithë kolegëve, me të cilët është diskutuar ky problem, nuk ekziston ndonjë nevojë për ta bërë këtë, sa kohë që barra administrative për të mbaruar procesin me gardën nuk është aq e madhe, krahasuar me policinë, si dhe për të mos krijuar idenë e standardeve të ndryshme për një personel, i cili është brenda së njëjtës fushë.

Ky ka qenë argumenti ynë. Megjithatë, mbetet në atributin e komisionit dhe vetë parlamentit për të parë si duhet vepruar. Ne këtë qëndrim kemi pasur dhe vazhdojmë ta kemi. Nuk është ndonjë nevojë e domosdoshme për ta përjashtuar gardën nga procesi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Një ndërhyrje për procedurë nga zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Desha të sqaroja zotin Murrizi. Ligji për vetingun nuk ka qenë produkt i luftës politike mes klaneve në PS, sepse nuk ekzistojnë. Policia e Shtetit është pjesë e zinxhirit të organeve ligjzbatuese dhe reforma në drejtësi e sjell si domosdoshmëri edhe vetingun në polici.

Janë katër institucione ligjzbatuese, si policia, prokuroria, gjykata dhe sistemi penitenciar, dhe është e domosdoshme që të gjitha këto të jenë të pastra. Ato janë interpretime që kanë dëshirë t'i bëjnë, që t'i hedhin helm kësaj historie, por s'ka lidhje. Jo vetëm që s'ka lidhje, por ne po e thjeshtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme çdo lloj faze të kryerjes së kësaj detyre, e cila është domosdoshmëri.

Ermonela Felaj – Po, një minutë.

Myslym Murrizi – Zoti Ndreu, nëse ecim me këtë logjikë, po veting në DSIK, do të ketë? Në drejtorinë e pastrimit të parave, do të ketë? Në shërbimin Informativ, do të ketë? Lërë atë! Erdhi Xhafaj këtu, donte të merrte kalanë e Tahirit, dhe tha se do të bënte vetingun, do të heq...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lërë mendimin, kështu është realiteti! Këtë mendim ke edhe ti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, këtë mendim ke edhe ti!

Ermonela Felaj – Atëherë, kolegë...

Myslym Murrizi – Atëherë bëjuni veting për të gjithë! Bëni veting për shërbimin e ushtrisë, se ka shërbim ushtria brenda.

Ermonela Felaj – Mendimin që kemi për këtë çështje e shprehim gjatë diskutimeve, si dhe në fund me votë. Nuk ka nevojë të hyjmë në komente për mendimin e njëri-tjetrit, besoj unë, se kjo nuk na ndihmon.

Fjalën e ka zoti Duzha. Më pas zoti Vorpsi.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Jam dakord me ato që shprehu zoti ministër, pasi në këtë rast, me këto ndryshime që ju kërkoni, përveç kohës ulet edhe kostoja financiare.

Unë kisha një pyetje, e cila është më shumë teknike.

Me sa di unë, trupa policore, të gjithë policët kanë plotësuar një formular me goxha faqe atëherë, duke marrë shumë vërtetime në shumë institucione shtetërore, si banka, apo ku di unë.

Çfarë do të bëhet me ato tashti që fillon procesi i vetingut nga SHQBA-ja? Do të merren më parasysh ato, apo SHQBA-ja ka metodat e veta për kryerjen e verifikimeve?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, një përgjigje nga zoti Hodaj. Besoj se edhe zoti Rrumbullaku mund të ndërhyjë.

Julian Hodaj – Faleminderit, e nderuara kryetare!

Të nderuar deputetë!

Nuk ndërron substanca e procesit, që do të thotë se nuk ndërrojnë as kriteret e vlerësimit, as mënyra se si do të kryhet vlerësimi dhe as baza mbi të cilën do të vlerësohen. Ashtu siç e shpjegoi edhe ministri më përpara, ai që ndryshon është mekanizmi. Pra, në vend që të kemi komision të dytë dhe të tretë, do të kemi SHQBA-në, që do të bëjë vlerësimin e këtyre punonjësve të nivelit të mesëm dhe të ulët.

Për t'iu përgjigjur direkt pyetjes tuaj, ato formularë do të jenë baza e vlerësimit. Janë tre formularë. Për të shmangur edhe një herë një keqkuptim të krijuar rëndom, nuk është se punonjësve të policisë u është kërkuar ndonjëherë që të paraqisnin vërtetime apo dokumente, por të ndikuar ndoshta edhe nga ajo që po ndodhte në vlerësimin e gjyqtarëve e prokurorëve, shumë prej tyre edhe i kanë paraqitur.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodaj!

Nuk e di, por a ka nevojë që të ndërhyri edhe ju për përgjigje, zoti Rrumbullaku? Në rregull!

Fjala është për zotin Vorpsi. Më pas për zotin Harusha dhe zotin Qefalia.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Natyrisht, e vlerësoj këtë ndryshim ligjor me argumentin kohor.

Natyrisht, pyetja që dua të bëj ka të bëjë me rolin e SHÇBA-së në lidhje me kohën (gati 16 muaj, se ligji ka efekt deri në vitin 2020).

A është në gjendje SHÇBA-ja me strukturën që ka sot, me 28 punonjës, ta përballojë me sukses këtë detyrë që është suplementare?

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Hodaj!

Julian Hodaj – Në fakt, në qoftë se keni parasysh mekanizmin, nga 28 punonjës që ka SHÇBA-ja, në fazë të fundit vetëm komisionet vendore do të ishin rreth 270 vetë.

Një nga pikat e propozuara si ndryshim i ligjit është edhe shfuqizimi i atij neni që parashikonte kohëzgjatjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, sepse bëhet fjalë pastaj për një

vlerësim periodik, që SHÇBA-ja do ta bëjë në vazhdimësi, prandaj një nga pikat është pikërisht heqja e atij afati, sepse në kushtet kur Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ka filluar punën vetëm në shkurt të këtij viti dhe është pothuajse e pamundur që ky proces të përfundojë brenda atij afati kohor që parashikon ligji në fuqi.

Në lidhje me kapacitetin e strukturës përgjigje mund të japë edhe drejtori, por duke hequr limitin kohor, sepse nuk mjafton një vit kohë për të kryer një proces rivlerësimi për një numër kaq të madh punonjësish.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Rrumbullaku!

Rrumbullaku – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Për sa i përket afatit kohor është një çështje që mbetet për t’u vlerësuar. Realisht, pas momentit që Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit të përfundojë procedurën e vetingut të SHÇBA-së dhe gjithë pjesës tjetër të normuar në bazë të ligjit, ne do të shikojmë sepse ligji parashikon fare qartë nenin 65 dhe daljen e një udhëzimi të ministrit të Brendshëm në lidhje me ngritjen e komisionit të brendshëm në nivel qendror dhe vendor.

Afati është kushtëzim i ligjit që të hiqet dhe ajo do të bëhet pastaj periodikisht.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Fjala është për zotin Harusha.

Luan Harusha - Faleminderit!

Unë jam dakord me ngritjen e këtij institucioni me rëndësi të veçantë siç është SHÇBA-ja, me specialistët e duhur. Kam diçka tjetër për vetingun në polici, pasi mendoj të rishikohet vetingu në polici, siç e tha edhe kolegu Murrizi, sepse ka policë që nuk kanë asnjë zanat tjetër, kanë bërë një shtëpi ndër vite, kanë një makinë, të cilën ua ka dhuruar një i afërm i tyre dhe të penalizohet për këtë mua nuk më duket shumë e drejtë.

Vetingu të bëhet, të kontrollohen, por për këto arsye them që nuk duhet të penalizohet një polic që ka 10-15 vjet në polici.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Hodaj!

Julian Hodaj – Në fakt, edhe mekanizmi i parashikuar nuk është i njëjti me atë që është parashikuar për gjyqtarët dhe prokurorët. Më e rëndësishmja në atë ku fokusohet ky ligj, që është sot në fuqi, është se nëpër formularë, qoftë tek ai i pasurisë, qoftë tek ai i personalitetit të jetë e

deklaruar e vërteta, sepse edhe nëse ka mospërputhje për shkak të rrethanave të ndryshme, siç mund të jetë një punë në emigracion, të ardhura nga emigracioni etj., etj., këto nuk janë rrethana që në vetvete penalizojë punonjësin e policisë.

Pra, theksin e kemi vënë në faktin që të jetë deklaruar e vërteta, sepse pastaj ka edhe një shpjegim për çdo rrethanë të deklaruar aty.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Harusha!

Luan Harusha – Faleminderit, zoti Hodaj!

Mund të ketë edhe një polic, me 20 vjet punë në polici, që me kursimet e tij, pa pasur asnjë jashtë, një herë ka bërë këtë, herën tjetër atë dhe ka përfunduar një shtëpi. Ne e dimë se në Shqipëri ka shumë njerëz, të cilët kanë përfunduar për 10 vjet një shtëpi, por duke deklaruar të vërtetën, automatikisht ai është i dalë jashtë sistemit. Një shtëpi, një makinë...

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Unë nuk besoj se është rasti që ne të paragjykojmë procesin e vetingut, ende pa filluar. Njerëzit që do të jenë në Komisionin e Jashtëm do të trajnohen edhe nga misionet ndërkombëtare që asistojnë Policinë e Shtetit. Ne vetë e kemi bërë këtë propozim në ligj, në mënyrë që procesi të jetë i kujdesshëm dhe i vërtetë.

Fjalën e ka zoti Hodaj.

Julian Hodaj - Te ligji ka një dispozitë specifike që edhe nëse ka pasuri të luajtshme, të paluajtshme që shkojnë deri në 200% të të ardhurave që justifikohen gjatë viteve nuk përjashtohet njeri nga sistemi. Kjo është bërë me një qëllim të caktuar, sepse të gjithë jemi koshtientë që Shqipëria është një vend emigrantësh, ku secili ose ka emigruar vetë, ose ka në përbërjen familjare emigrantë të tjerë dhe prandaj është vënë ky kriter. Presupozohet të jetë si justifikim për të gjithë ato burime të ardhurash që për momentin nuk mund të kenë dokumente shoqëruese apo suportuese.

Te pjesa e pasurisë kjo është bërë me një qëllim mjaft të qartë, që është mospenalizimi i këtyre rasteve. Në ligj e keni që deri në 200% të pasurisë nuk penalizohet.

Ermonela Felaj - Kjo është e vërtetë, duhet të kalojë dyfish e gjysmë të pasurisë, pastaj të konsiderohet se ka fshehur pasurinë.

Xhemal Qefalia - Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, nisma e sotme nuk ka sesi të kalojë pa vëmendjen e opinionit publik, por edhe të organizatës së policisë, që për hir të së vërtetës duhet të pranojmë se ka qenë e frustruar nga vetë

fjala, nisur dhe nga shenja e barazisë që bëhen midis vetingut në sistemin gjyqësor edhe vetingut në polici. Kemi pasur kontakte me mjaft punonjës policie, të cilët e kanë marrë vërtet si një masë të frikësuar.

Meqenëse jemi te pyetjet, nuk do të ndalem në gjëra të përgjithshme, sepse kam bindjen e plotë që vazhdimisht kolegu Ndreu sa here që zhvillojmë biseda për policinë artikulon shumë saktë, pasi ka qenë dhe vetë në këtë organizatë. Gjithsesi, besoj edhe me mirëkuptimin e zotit Ndreu që të kemi të drejtë edhe ne të tjerët që nuk e kemi pasur këtë mundësi, pasi gjykojmë në një aspekt, ndoshta edhe të pandikuar.

U diskutua për sa i përket amnistisë që bëhet për informacionin. Nga ky artikulum dhe nga kjo dëgjese, ndoshta për opinionin publik duhet sikur ne si maxhorancë po amnistojmë të gjitha veprat, krimet që janë kryer nga policia gjatë kësaj kohe që ne qeverisim. Këtu bëhet fjalë për informacione. Këtu lind edhe pyetja për ju, zoti Rrumbullaku, sepse për sa u përket masave disiplinore nëpër rregulloret tuaja të brendshme është përcaktuar qartë që masat disiplinore kanë një afat kohor që edhe suprimohen, bien me kalimin e afateve 6-mujore apo 1-vjeçare, a ndodh e njëjta gjë edhe në informacionet në dosjen e oficerëve të policisë? Pra, bëhet fjalë për informacione që regjistrohen nga shërbimi juaj dhe këto vazhdojnë ta ndjekin si hije nga pas punonjësin e policisë në vitet e gjata.

Pyetja tjetër, më vjen mirë, ne jemi po këta deputetë që e kemi votuar para një viti këtë ligj, mendoj se në tërësi është bërë mirë, pasi në momentin që certifikohet një punonjës policie, kalon vetingun ndihet më krenar për momentin e parë, por jam dakord me ju, sepse këtu ka një dinamikë zhvillimi dhe nuk bëhet fjalë: “e more *carta bianca*-n në xhep dhe je i pastër gjatë gjithë kohës”. Kjo ndodh edhe për gjyqtarët, edhe për prokurorët. Ata që kalojnë vetingun nuk do të thotë se nuk do të jenë më të korrumpuar, sepse po ta besojmë këtë do të krijojmë njerëz të shenjtë dhe të paprekshëm, por meqenëse jemi këtu pyetja është: ne e kemi përcaktuar te ligji që miratuar vjet, se këtu do t’iu lind e drejta dhe ish-punonjësve të policisë, të cilët janë larguar nga sistemi. Pra, ata që pranojnë për t’u vetuar, për të kaluar në veting kanë të gjithë të drejtën për t’u paraqitur pranë komisioneve përkatëse. Ndërkohë, ne kemi një ligj të miratuar ligjin “Për Policinë e Shtetit” që nuk i lejojmë punonjësit e policisë të rikthehen përsëri në detyrë. A ka një handikap këtu, a është menduar se si do të kapërcehet kjo gjë?

Ermonela Felaj - Kush do të përgjigjet nga ju?

Po, zoti Rrumbullaku.

Muhamet Rrumbullaku – Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes së parë, në lidhje me informacionin e të dhënave që ndodhen në bankën e të dhënave të SHÇBA-së, nga një hulumtim që unë i kam bërë prognozës reale të shërbimit, rezulton se në shërbim administrohen të gjitha të dhënat që nga momenti i krijimit të shërbimit, pra gjatë gjithë kësaj kohe nuk është marrë asnjë lloj vendimi për sa i përket deklasifikimit të të dhënave dhe informacioneve. Me mbështetjen e ministrit të Brendshëm ka filluar ky proces. Nga momenti i ndryshimeve në ligj dhe marrjes së përgjegjësisë për sa i përket vetingut, ne do të kemi kohë në dispozicion për ta realizuar këtë proces, i cili nuk realizohet vetëm nga shërbimi dhe nga unë si drejtues i institucionit, por do të ketë mbështetje, që do të jepet nga vetë komisioni dhe nga agjencitë e tjera, si dhe nga Arkivi i Shtetit në përbërje të grupeve të veçanta. Ne do të paraqesim një material të detajuar për zotin ministër dhe pas kësaj iniciative, do të jemi në kontakt edhe me aktorët e tjerë, që do të jenë pjesë e këtij deklasifikimi të informacionit dhe të të dhënave.

Xhemal Qefalia - Sipas opinionit tuaj personal, a mendoni se është e nevojshme të bëhet një gjë e tillë, apo bëhet meqë e thotë ministri?

Muhamet Rrumbullaku - Kjo nuk ka të bëjë me opinionin tim. Kjo është një kërkesë e ligjit. Ky është një proces, i cili ka mbetur i paezauruar ndër vite. Nuk është kërkesë e ministrit, por është kërkesë e ligjit për të cilën unë i kam relatuar ministrit.

Për sa i përket pyetjes së dytë, i lë fjalën zotit Hodaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Hodaj!

Julian Hodaj - Në fakt ka qenë një argument që e kemi diskutuar edhe në filim kur kemi miratuar ligjin. Në dijeninë tonë janë 160-170 mijë punonjës me grada dhe me nivele të ndryshme, që kanë dorëzuar dokumentacionin.

Natyrisht, këto do të merren në konsideratë nga komisionet përkatëse. Nëse këto ndryshime do të kalojnë sot, nëse i përkasin klasave drejtuese të larta merren në shqyrtim nga komisioni i jashtëm i vlerësimit, nëse i përkasin klasave drejtuese të mesme apo të ulëta, merren në shqyrtim nga SHÇBA-ja dhe garantohet rimarrja e tyre në punë, sipas ligjit të vlerësimit kalimtar.

Ajo që thatë ju, që ka një mospërputhje normash ndërmjet ligjit për Policinë e Shtetit dhe ligjit për vlerësimin kalimtar, është e vërtetë. Në vlerësimin tim kjo përplasje është vetëm aparente,

pasi kemi të bëjmë me dy ligje të ndryshme dhe kufiri 2-vjeçar i referohet mundësisë për t'u rikthyer në momentin që largohet në bazë të kushteve të ligjit për Policinë e Shtetit, ndërsa këtë tjetrën e konsiderojmë një derë të re hyrjeje në Policinë e Shtetit.

Gjithsesi, mendoj që të evitohet çdo lloj keqkuptimi apo keqinterpretimi, do të ishte e arsyeshme që të adresohet kjo, edhe te ligji për Policinë e Shtetit.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Xhindi!

Anduel Xhindi – Faleminderit, kryetare!

Unë kisha 2 pyetje.

E para, a e keni menduar gjatë hartimit të këtij drafti se sa kohë mund t'i duhet komisionit për të shqyrtuar një dosje të punonjësit të policisë?

Pyetja e dytë, është për drejtorin e Përgjithshëm. A i ka marrë masat Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për plotësimin e vendeve vakante, që mund të krijohen gjatë procesit të vetingut të policisë?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Xhindi!

Fjalën e ka zoti Hodaj!

Më pas e ka fjalën zoti Veliu!

Julian Hodaj – Faleminderit, zoti Xhindi për pyetjen!

Në lidhje me pyetjen e parë, nga një llogaritje paraprake ishte menduar që faza e vlerësimit të parë, duke pasur 30 veta si komision dhe si sekretariat, duke pasur parasysh që mbi bazën e parashikimeve aktuale të ligjit nënshtrohen rreth 245-250 punonjës, është llogaritur që në rastin më të mirë, kjo fazë zgjat 8 muaj dhe në rastin më të keq, zgjat 12 muaj. Flasim për grupin e parë prej 245-250 punonjësish, siç parashikohet sot në ligj.

Me shtimin e SHÇBA-së si institucion në fazën e parë, besoj se koha do të rritet në proporcion.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Veliu!

Ardi Veliu- E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Në lidhje me pyetjen tuaj, padyshim që në Akademinë e Sigurisë vazhdon procesi i rekrutimit, por në respekt dhe në zbatim të ligjit, procesi i rekrutimit fillon nga grada inspektor dhe padyshim, në momentin që do të zbatohet ligji do të krijohet vakuum për sa i përket disa niveleve në grada. Me ndryshimin që iu bë ligjit të ri për Policinë e Shtetit dhe drejta e rimarrjes në Akademinë e Sigurisë edhe nga degë, të cilat nuk janë të përfaqësuara aktualisht në Policinë e Shtetit dhe, duke mos respektuar shkallën e promovimit në karrierë nga grada “inspektor” dhe shkallët e tjera, do ta lehtësojë sadopak vakuumin që do të krijohet, por mendoj se do të kemi vakuum.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Nimet Musai!

Njëkohësisht, i uroj mirëseardhjen në Komisionin e Sigurisë.

Nimet Musai – Faleminderit, kryetare!

Falënderoj edhe relatorin, zotin Ndreu!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Ministër,

Të nderuar drejtorë,

Ky është një projektligj për t’u vlerësuar, i cili na jep mundësinë të shohim ndryshimet e mëdha që po ndodhin. I mbështes 2 propozimet e relatorit për amnistinë e informacionit, si dhe për Gardën. Unë nuk e di se sa është numri i punonjësve, që do të kalojnë vetingun. Nëse është një numër i kufizuar, normalisht edhe mund të kalojnë.

Do të doja të dija nga zoti Veliu, nëse Akademia e Sigurisë me këta djem dhe vajza që ka, a e ka performancën dhe aftësitë profesionale, në mënyrë që mbas këtij vetingu këta djem dhe vajza të na përfaqësojnë denjësisht?

Faleminderit!

Ardi Veliu - Faleminderit!

Siç e theksova pak më parë, me ndryshimet që u bënë në ligj, rekrutimi në Policinë e Shtetit veç kalimit nëpërmjet kolegjit profesional policor, është edhe rimarrja drejtpërdrejt në Fakultetin e Hetimit dhe Krimit e qytetarëve, të cilët mbasi kanë mbaruar një shkollë të lartë, mund të bëhen pjesë e Policisë së Shtetit mbas kalimit të fazave dhe të proceseve të rekrutimit. Mendoj se Akademia e Sigurisë ka një periudhë 4-vjeçare që po kalon në një proces reformimi për sa u përket kurrikulave, programeve të shkollimit dhe nga dita në ditë, është duke u rritur

profionalisht, duke nxjerrë punonjës më të aftë policie. Unë mund të them se sot është dita e fundit e shkollës për ciklin 3-vjeçar. Është grupi i dytë që po diplomohet në Akademinë e Sigurisë mbas një pauze 7-8-vjeçare, që nuk diplomonte nënkomisarë të denjë për Policinë e Shtetit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Velu për sqarimet e pyetjeve që ju bënë.

Meqenëse nuk ka pyetje të tjera në parim për projektligjin, ftoj kolegët të votojmë në parim projektligjin e sjellë.

Kush është dakord në parim me ndryshimet e propozuara nga Ministria e Brendshme në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me diskutimin nën për nën të projektligjit. Në rast se dikush nga kolegët do të ketë pyetje për ndonjë nën të veçantë, mund ta ezaurojmë gjatë diskutimit.

Në nenin 1 të projektligjit propozohet ndryshimi i pikës 4 të nenit 3 të ligjit për vetingun në polici. (Për lehtësi komunikimi do ta quaj kështu gjatë gjithë diskutimit)

Ligji parashikonte që institucionet e vlerësimit kalimtar të ishin Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Komisioni Qendror dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit, por sipas propozimeve që u bënë, tani do të jetë vetëm Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit për pjesën e gradave të larta dhe më pas të gjithë procesin do ta vijojë Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Kush është dakord që kjo pikë e përkufizimeve të ndryshojë? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pika 2 e nenit 1 të projektligjit propozon shfuqizimin e pikës 21 të nenit 3 të ligjit. Besoj se kjo vjen edhe nga përmbajtja e projektit që propozohet.

Adnor Shameti – Për procedurë dhe ekonomi **gjyqësore**, për sa kohë që nuk ka ndryshime nga tabela e paraqitur, mendoj të shmangim komentet dhe përsëritjen një për një e të gjitha neneve dhe të vazhdojmë me votimin.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Jo se unë nuk e kisha parasysh këtë gjë, por po i lexoja për të tërhequr vëmendjen e kolegëve aty ku ne mund të kemi ndonjë diskutim për të bërë apo sugjerim për amendim.

Kush është dakord që pika 2 e nenit 1 të miratohet siç propozohet nga Ministria e Brendshme? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2.

Tabela i ndihmon të gjithë kolegët të shikojnë se si ka qenë ligji aktual dhe si janë propozimet.

Kush është dakord me nenin 2 të projektit të propozuar? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 i projektit ka të bëjë me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së organeve të vlerësimit kalimtar. Propozohet që të gjithë punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat t'i nënshtrohen vetimit nga ana e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit. Pra, jo vetëm drejtori, zëvendësdrejtori i përgjithshëm dhe shefat e sektorit në SHÇBA, por e gjithë struktura e SHÇBA-së, me 125 vetë në mos gaboj, t'i nënshtrohen vetimit nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

Kush është dakord me këtë propozim?

Faleminderit!

Përpara se të vazhdojmë me miratimin në tërësi të nenit, kam një sugjerim për propozuesit e projektligjit. Neni aktual parashikon që vetimi i komandantit, zëvendëskomandantit dhe çdo oficeri me gradë major, nënkolonel dhe kolonel në Gardën e Republikës të bëhet nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. Duke marrë parasysh sugjerimin e relatorit për funksionin tipik të Gardës, i cili nuk është i njëjtë me funksionin e Policisë së Shtetit, pavarësisht se Garda është e përfshirë në Policinë e Shtetit, unë propozoj (kuptohet që dua të dëgjoj edhe opinionin tuaj) që Garda e Republikës të mos i nënshtrohet vetimit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, por vetimit të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si gjithë pjesa tjetër e Policisë së Shtetit.

Dua të dëgjoj një opinion nga zoti Rrumbullaku.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Çfarë qëndrimi keni për këtë?

Julian Hodaj – Së pari, i qëndroj mendimit, që e shprehu edhe ministri më parë, që Garda duhet të kalojë në këtë proces vlerësimi kalimtar.

Së dyti, nëse meraku juaj, me të drejtë, është shkurtimi i kohës së vlerësimit të fazës së parë dhe ulja e numrave, nga një llogari jona paraprake na rezulton se komandanti,

zëvendëskomandanti dhe oficerët me gradë major, nënkolonel dhe kolonel janë rreth 80 persona. Pra, në parim nuk jemi kundër nëse ndonjë gradë më e ulët e linjës lihet për fazën e dytë dhe të tretë. Për ne nuk ka ndonjë problem nëse komandanti, zëvendëskomandanti dhe oficerët kalojnë në fazën e parë dhe pjesa tjetër kalon në fazën e dytë dhe të tretë.

Ermonela Felaj – Po, zoti Rrumbullaku.

Muhamet Rrumbullaku – Bashkohem me mendimin e zotit zëvendësministër për sa i përket nivelit të lartë. Komandanti i Gardës së Republikës dhe funksionet e barasvlershme me gradën e kolonelit duhet të kalojnë në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, sepse Shërbimi i Çështje të Brendshme nuk mund të votojë një nivel të tillë përderisa edhe niveli tjetër i policisë në këto grada të barasvlershme kalon nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

Ermonela Felaj – Pra, biem dakord që komandanti dhe zëvendëskomandanti i Gardës të vetohen nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, kurse e gjithë pjesa tjetër e Gardës, duke përfshirë edhe kolonelët, të vetohet nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat.

Pjerin Ndreu – Për mendimin tim ka dy rrugë: ose Garda të hiqet fare, ose, nëse ngelet, komandanti dhe zëvendëskomandanti të kalojnë te Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. Unë ngul këmbë që duhet të hiqet. Është një ngarkesë e kotë, sepse për shkak të specifikës së shërbimit nuk ka ndonjë impakt. Janë shërbime dhe njerëz që kanë të bëjnë me personalitete dhe vendet ku ata rrinë, rezidencat, vendet ku ushtrojnë detyrën, personalitete shqiptare dhe homologë të tyre.

SHÇBA-ja të bëjë detyrën e vetë funksionale në vazhdimësi për të evidentuar ndonjë fenomen, por nuk është e rëndësishme ta ngarkojmë me veting njësoj si Policinë e Shtetit. Duhet ta përjashtojmë ose ta lëmë kështu siç është.

Ermonela Felaj – Unë do të vijoj argumentin e zotit Ndreu për faktin që pak më poshtë ne duhet të diskutojmë patjetër edhe për afatin e punës së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, sepse fillimi i punës së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat është i lidhur me mbarimin e punës nga ata. Nëse ne ata do t'i lëmë pa afat, kur do ta fillojë punën Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat për sa i takon të vetuarit të organeve të Policisë së Shtetit? Kështu që, duke dashur t'i japim një ngarkesë të arsyeshme Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, e cila të shkarkohet po ashtu në mënyrë të arsyeshme brenda një afati të duhur, imagjinoni që në ligj ne kishim parashikuar 2 vjet për vetimin e të gjithëve. Patjetër që do të na duhet të mendojmë një afat për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit.

Do të doja edhe një ndërhyrje nga zotit Hodaj këtu. Në qoftë se ne heqim Gardën e Republikës, komandantët, zëvendëskomandantët, shefat dhe gjithë atë që është shkruar këtu dhe t'ia lëmë vetimin e gjithë Gardës SHÇBA-së, sa shkon numri i atyre që duhet të votojë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, në mënyrë që kur të shikojmë tek afati që do të propozojmë, të jemi sa më korrektë?

Julian Hodaj – Zonja kryetare, komandantë, zëvendëskomandantë, majorë, kolonelë dhe nënkolonelë janë 80-90 vetë. Numrin e saktë të tyre nuk e kam. Nëse heqim majorë dhe nënkolonelë...

Ermonela Felaj – Do të ngelet me 200 vetë, në qoftë se heqim... Numri i atyre që do të votojë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit në relacion ka qenë i përlogaritur për 297 vetë. Në qoftë se ju thoni se kemi 80-90 vetë te Garda, i takon që rreth 200 vetë do të votojë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

Julian Hodaj – Duhet të shtoj diçka. Komandantë, zëvendëskomandantë dhe kolonelë, në mos gabo, janë 12 vetë. Gradat major dhe nënkolonel e shtojnë numrin. Komandantë, zëvendëskomandantë dhe kolonelë janë 12-13 vetë, jo më tepër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj - ...një ndërhyrje nga zoti Shameti, që të gjejmë një zgjidhje.

Adnor Shameti – Faleminderit, kryetare!

Për procedurë, do të sugjeroj që, në vijim të fjalës suaj, të vini me një propozim konkret, ta votojmë atë dhe... Pra, nga propozimi më i largët, te më i afërti, atë që tha zoti Ndreu dhe atë që po thoni ju.

Nëse ju e gjeni gjuhën, të vini me një propozim të përbashkët. Në të kundërt, të shikojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra. Për këtë po flas.

Ermonela Felaj – Unë besoj se është mirë të gjejmë gjuhën e përbashkët. Ky është një ligj, që është vendosur të kalojë me procedurë të përsheptuar.

Adnor Shameti – Dakord. Po them se në kuptimin procedural... Kemi dy propozimi, një juaji dhe një i zotit Ndreu.

Ermonela Felaj – Dakord, por meqenëse këto nuk janë personale...

Adnor Shameti – Pa diskutim, por për procedurë shqyrtohet më parë propozimi më i largët, pastaj më i afërti me draftin që është këtu dhe ta votojmë...

Ermonela Felaj – E kuptoj.

Unë mendoj se do të na ndihmonte më shumë opinioni dhe qëndrimi i gjithsecilit.

Në qoftë se ne lëmë komandantë, zëvendëskomandantë dhe majorë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Major është më e ulët, se në renditje e keni vënë majorin para dhe kolonelin e nënkolonelin mbrapa, prandaj...

Atëherë, komandantë, zëvendëskomandantë dhe kolonelë, sa vetë bëhen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

86 vetë kemi pak a shumë te Garda, me sa kujtoj edhe nga raportimet që ka bërë Garda në këtë komisioni. Pjesën tjetër t'ia lëmë SHÇBA-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Atëherë, kush është dakord me logjikën që germën “b” të nenit 6 të ligjit aktual ta rishkruajmë, duke lënë që vetëm gradat e larta, komandant, zëvendëskomandant dhe kolonel, t'i nënshtrohen vetimit nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit? Më pas gjithë pjesa tjetër, oficerë, majorë e çfarë ka Garda e Republikës, ta vazhdojnë vetimin me SHÇBA-në.

Kush është dakord me këtë propozim?

Kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Besoj se gjetëm një zgjidhje të arsyeshme, duke amenduar nenin 3 të propozuar nga Ministria e Brendshme, me rishkrimin e germës “b” të pikës 1 të nenit 6 të ligjit aktual.

Po kështu, te neni 6 propozohet të ndryshojnë edhe dy pika të tjera. Bëhet fjalë për ndryshimin e pikës 2 të nenit 6 dhe të pikës 3 dhe 4 të nenit 6. Propozohet që ato të shfuqizohen.

Kush është dakord me propozimin e sjellë nga Ministria e Brendshme për këtë rast?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 3 i projektit.

Kalojmë te neni 4 i projektit, i cili ka të bëjë me veprimtarinë e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Do t'i rikthehem propozimit që bëra para se të votonim këto nene. E kemi të nevojshme t'i vëmë një afat pune Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Për parantezë, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit është konstituuar si organ. Janë zgjedhur 15 anëtarë, të cilët vijnë nga shoqëria civile, nga institucione të ndryshme publike me ato kritere që

parashikon ligji. Janë përzgjedhur edhe 15 anëtarët e Sekretariatit Teknik, që do të jetë në mbështetje dhe në ndihmë të komisionit. Komisioni do të funksionojë me 5 trupa, ku çdo trupë është e përbërë nga tre anëtarë dhe ka në mbështetje 3 sekretarë. Është kaluar edhe vendimi i Këshillit të Ministrave për pagën e tyre.

Për korrektesë dhe transparencë me median, duhet t'ju them se paga e anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit është 190 mijë lekë të rinj në muaj. 110 mijë lekë të rinj është paga e anëtarëve të Sekretariatit Teknik. Besoj se vlerësimi është adekuat, duke pasur parasysh nivelin dhe klasifikimin e pagave në Republikën e Shqipërisë.

Shpresoj që ju të keni ecur me sigurimin e kushteve, sepse kjo është një detyrë, që i takon Ministrisë së Brendshme, jo parlamentit.

Dua t'ju pyes, zoti Hodaj, sepse keni qenë që në fillimet e punës së ndërtimit të këtij projekti dhe jeni më i familjarizuar me numrat dhe me kohën: sa mendoni se duhet të jetë afati maksimal që duhet t'i lejojmë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit për të vetuar më pak se 290 vetë?

Julian Hodaj – Në fakt, zonja kryetare, duhet t'i ribëjmë pak llogaritë, sepse në kushtet kur ishte llogaritur të kalonin 245 vetë në veting, llogaritej që koha më e shkurtër të ishte 8 muaj dhe koha më e gjatë 12 muaj. Në kushtet kur vërtet kemi hequr një pjesë të punonjësve të Gardës së Republikës me këto ndryshime që ju propozuat dhe, nga ana tjetër, me ndryshimin e ligjit propozohet të shtohen të gjithë punonjësit e SHÇBA-së, mendoj se një vit do të ishte kohë e mjaftueshme që komisioni të mbaronte punë.

Ermonela Felaj – Kolegë, propozimi, që vjen nga zoti Hodaj, është që 1 vit do të ishte i arsyeshëm, që Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit të mbyllte procesin e vetimit me gradat e larta, apo jo?

Urdhëroni!

Person – Zonja kryetare, nuk është propozim që vjen nga Ministria e Brendshme, por përgjigje ndaj pyetjes suaj se për sa kohë mendojmë ne që mund të kryhet ky proces, që të jemi të saktë.

Ermonela Felaj – Dakord.

Edhe ne po bëjmë një llogari të përafërt. Duke menduar që kemi 290 veta, 5 trupa vlerësimi që punojnë me kohë të plotë, sepse janë të shkëputur nga punët e tyre dhe vijnë te komisioni dhe sekretariati, personalisht, duke dëgjuar përgjigjen e pyetjes që bëra, por duke bërë edhe llogaritë

vetë, mendoj që 1 vit do të ishte afat i arsyeshëm për qëllimin që kemi ne, që të përmbyllet ky proces dhe të fillojë procesi në të gjithë pjesën tjetër masive.

Nga ana tjetër, duke qenë se parlamenti ka ngritur nënkomisionin parlamentar, që ndjek monitorimin e zbatimit të këtij ligji, ne kemi mundësi të ndjekim si vijon puna nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe, në rast se do të ketë arsye objektive, që nuk do të lejonin përfundimin e punës brenda këtij afati, ne mund ta ndryshonim sërish, por kemi nevojë të vendosim patjetër një afat. Do të ftoja të gjithë kolegët të më thonë se sa mendojnë që mund të jetë afati.

(Diskutime pa mikrofon.)

Mund ta kemi përgjigjen me mikrofon, zoti Shameti? Më pas zonja Ekonomi.

Adnor Shameti – Zonja kryetare, unë mendoj që afati 1-vjeçar është maksimumi që duhet të krijojmë në këtë rast, që të kryhet i gjithë procesi, të mos ngelet në kalendat greke edhe për integritetin e trupës dhe gjithçka tjetër.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Mendoj se ne nuk kemi pse ta zgjasim pafund. Ne kishim planifikuar që për 2 vjet të kalonim 14 vjet, kurse tani kemi arritur te shifra 200 dhe te leja 1 vit. Mendoj se, nëse duhet të punohet, komisioni është ngritur, formularët pothuajse janë dorëzuar, dhe mendoj se duhet ta shkurtojmë afatin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Nga llogaritë që bëmë tani, me bazën e ngarkesës dhe trupave që kemi, del përafërsisht që duhen rreth 10 muaj, ndërkohë që nëse e lëmë 1 vit, nuk prish ndonjë punë. Mendoj se 1 vit është i mjaftueshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, ndaj u kthyem mbrapsht, sepse nuk i kishim bërë mirë llogaritë, siç po i bëjmë tani. Ka të drejtë zonja Felaj kur thotë se na nevojitet një kohë për ta përmbyllur detyrën.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – Atëherë, nga mendoni ta llogarisim fillimin e afatit? Nga hyrja në fuqi e ligjit?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër.

Besoj se jemi dakord që pika 13 e nenit 4 të projektit, neni 13 i ligjit aktual, që, në fakt, është neni 4 i projektit, të riformulohet duke i vendosur afat pune Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, që shkon 1 vit nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara në këtë projekt. Pra, “Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit e ushtron veprimtarinë e tij për vlerësimin e kategorisë përkatëse të punonjësve sipas nenit 6 të këtij ligji brenda 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të këtij ligji”.

Jemi dakord me këtë formulim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit, kolegë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pyeta nëse kishte kundër.

(Diskutime pa mikrofon.)

Neni 5. Propozohet të shfuqizohen nenet 14, 15, 16, 17 deri te neni 23 të këtij ligji. Kush është dakord?

Pranohet edhe ky ndryshim.

Faleminderit!

Kalojmë në nenin 6 të projektit, që ka të bëjë me drejtuesit e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit. Kush është dakord për nenin 6 të projektit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në nenin 7 të projektit. Kush është dakord me nenin 7 të projektit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë në nenin 8 të projektit.

Në fakt, e gjithë pjesa tjetër e neneve janë vetëm ndryshime për shkak se ishin komisione qendrore dhe vendore të vlerësimit.

Jeni dakord me nenin 8? Kundër? Abstenim? nuk ka.

Miratohet neni 8.

Kalojmë në nenin 9, që shfuqizon nenin 68 të ligjit. Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Neni 10, “Hyrja në fuqi e ligjit”, për të cilin propozohet afati i zakonshtëm 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare. Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit të propozuar nga Ministria e Brendshme “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”. Kush është dakord me propozimet e ndryshuara në këtë ligj? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju falënderoj, kolegë dhe përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, për vëmendjen!

Nesër do të kemi mbledhje në orën 10:00 për ratifikimin e një marrëveshjeje që ka të bëjë me fondet IPA.

MBYLLET MBLEDHJA